

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë kontestimore e shkallës së parë, sipas gjyqtarit Raif Fazliu me sekretaren juridike Mejreme Uka, duke vendosur në qështjen kontestimore të paditësit A. R. (Q.) nga xx Komuna e Vitisë, kundër të paditurit R. M (v), djali i të ndjerit V.M. (Xh.), ish nga fsh. Viti , tani me adresë të panjohur, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm I. S, avokat në Viti, baza e kontestit vërtetim i drejtës së pronësisë në bazë të shitblerjes, e pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, me datë 28.12.2016, shpall këtë:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A. R.. (Q.) nga fsh. .. k.Viti dhe **i njihet** e drejta e pronësisë në ngastrën kadastrale nr. **xxx**, në sipërfaqe prej 439 m², në vendin e quajtur “fshat oborr”, në Zonën Kadastrale P..., **në bazë të shitblerjes**. Ngastra në lindje kufizohet me ngastrën nr. xx-2, në jug me rrugën publike P.-Kllokot, në perëndim me ngastrën nr.lxx-0, ndërsa në anën veriore me ngastrën nr.xxx-0 dhe e njëjta është e regjistruar në emër të M. V.(Xh.).

DETYROHET i padituri R. M.q (V.), tani me adresë të panjohur, t’ia njeh të drejtën e pronësisë paditësit A. R.dhe ta duroj që ngastrën e lartpërmendur ta regjistroj në emrin e tij.

Ky aktgjykim për Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Vitisë, paraqet bazë, që në regjistrat kadastralë, të bëhet ndryshimin.

II.Shpenzimet e procedurës do t’i heq paditësi.

A r s y e t i m

Gjykata të paditurit i kishte dërguar përgjigje në padi, por përgjigjja ishte kthyer, sepse të paditurit ishte e pamundur ti gjindet adresa e vendbanimit apo vendqëndrimit, sepse ne fletëkethese thuhej se i padituri ishte shpërngulur ne Serbi.

Në seancën përgatitore me datë 14.12.2016, paditësi A. R., ka mbetur në tërsi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke i propozuar gjykates qe të paditurit R. M.t’i caktohet nje perfaqesues i perkohshem, ashtu që gjykata kishte vendosur per kete propozim duke caktuar perfaqesuesin e perkohshem per te paditurin , av. I. S..

Gjithashtu në kete seancë paditesis kishte propozuar caktimin e nje eksperti te gjeodezisë dhe s”bashku me te gjykata te del ne vendin e ngjarjes per te identifikuar dhe perkufizuar ngastren kontestuese.

Në vendin e ngjarjes në P...me 23.12.2016, gjykata kishte konsatuar se paditesis A. R.e shfrytëzon ngastren, në të cilën kishte ndërtuar një shtëpi banimi, te cilen e kishte meremetuar në terësi.

Përfaqesuesi i përkohshëm i të paditurit av. I.S. nuk e kishte kundërshtuar identifikimin dhe perkufizimin që kishte bërë eksperti gjeodet M. L. për ngastrën në fjalë, por e kishte kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit, duke rezervuar të drejtën për deklaram në seancën kryesore.

Në seancen kryesore të datës 28.12.2016, paditesis kishte mbetur pranë padisë dhe kërkesepadisë, duke theksuar se ngastren kontestuese nr.xxx1, e kishte blere nga i padituri nga viti 2013, kur edhe e kishte paguar çmimin e kontraktuar dhe kishte hy ne posedim te pa penguar. Çmimi i

kontraktuar ishte 20,194 €uro, të cilat ia kishte dhënë te paditurit. Po ashtu ai kishte propozuar të dëgjohet dëshmitari R.R., nga fsh. .. K. Vitisë.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit av. I. S., nuk e kishte kundërshtuar propozimin e paditësit për dëgjimin e dëshmitarit.

Dëshmitari R. R. nga fsh. P...., kishte deklaruar se, ju garantoj me përgjegjësi morale, penale dhe material se këtë arë paditësi e kishte blerë nga babai i të paditurit, por pasi që shitësi kishte vdekur në nderkohë, bartja nuk ishte kryer për deri sa nuk kishte kaluar një vit, sepse ashtu e kanë adet sërëbët. Andaj paditësi është detyruar të ushtroj padi. Paditësi kishte paguar çmimin kontraktues dhe kishte hy në posedim, ku tani ka ndertuar shtëpi banimi.

Dëshmitarin e kishte pyetur përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit duke iu përgjigjur se shitësi ishte i kënaqur me çmimin e kontraktuar.

Gjykata kishte lexuar dhe shtjelluar keto prova, ishin lexuar çertifikata e pronës për ngastren kontestuese nr.1...xx-1, në emër të pronarit juridik M. V. (X.), kontrata private mbi shitblerjen e paluajtshmerisë e dates xxx, ishte lexuar një Procesverbal (Pajtimi Gjyqësor), me nr.5-xxx i dates xxx, i përpiluar pranë Gjykatës së Parë Themelore në Beograd, lexohet përgjigjja me nr.xxx/vd, e datës 21xxx, nga ana e Agjencionit Kosovar të Pronës dhe lexohen ekspertiza e kryer nga eksperti i gjeodezisë M. L. e datës xxx për ngastrën kontestuese.

Palët nuk i kishin kontestuar këto prova.

Paditësi në fjalën e tij përfundimtare kishte deklaruar se nga të gjitha provat e administruara, pa dyshim vërtetohet se gjatë vitit 2013, e kishte blerë ngastrën kadastrale të shenuar si në dispozitiv, ku ia kishte paguar çmimin në tërësi dhe ishte hy në posedim të pa ndërprerë, nga viti 2013, si posedues i ndergjegjshëm.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit, av. I.S. cili deri në fjalën përfundimtare e kishte kundërshtuar kërkesëpadinë, në fjalën përfundimtare nuk i kishte kundërshtuar provat e administruara, ku edhe ishte shprehur në favor të këtyre provave, duke i propozuar gjykatës që në bazë të tyre edhe të bëjë aktgjykim.

Gjykata duke u bazuar në nenin 8, të LPK-së, veçoi provat veç e veç dhe si tërësi..

- Me leximin e certifikates së pronës për ngastren kontestuese nr.xxx1-1, në emër të pronarit juridik M. V. (Xh.), gjykata vërteton se padia përputhet plotësisht në subjektet si palë kontestuese.

- Me leximin e kontratës private mbi shitblerjen e paluajtshmerisë të dates xxxxx, gjykata vërteton se paditësi nga i padituri e kishte blerë ngastren kontestuese për çmimin prej 20,194 euro.

- Me leximin e Procesverbalit me nr.5-xxx, i dates xxx, i përpiluar pranë Gjykatës së Parë Themelore në Beograd, gjykata vërteton se sipas tij të paditurit Mx Rx i kishte takuar ngastra kontestuese nr.xxx, pra për mënyrë të kësaj procesverbali, me pajtim Gjyqësor, ishte ndarë pasuria ndërmjet pasardhësve të Mx V.(Xh.), pra ndërmjet R. dhe motres së tij M. Sl...

-Ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë M. L. tregon përputhshmërinë e kërkesëpadisë në aspektin formal me gjendjen faktike në terren, si dhe gjendjen aktuale mbi shfrytëzimin e kësaj ngastre kadastrale dhe kontestuese.

-Deklaratat e dëshmitarit R. R., e dhënë në séancën e fundit të shqyrtimit gjyqësor, e forcon kërkesën e paditësit në një tërësi anë dhe besimin e gjykatës për ndodhjen e punës juridike.

-Kërkesa për verifikimin e adresës së të paditurit dhe përgjigjja nga Nenstacioni Policor në fsh... K.Viti e arsyeton vendimin e gjykatës, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurin, sikur që e arsyeton procedimin e kësaj lënde dhe vendosjes, përgjigjja me nr.xxx, nga AKP-ja, se vërtetë për këtë ngastër kadastrale askush nga personat fizik e as nga ata juridikë nuk ka paraqitur kërkesë lidhur me këtë ngastër.

Gjykata ka vërtetuar se në mes paditesit A. R. dhe të paditurit M.. R., kishte egzistuar raporti juridik, i cili edhe pse i lidhur jo në formën zyrtare të shkruar ka prodhuar efekt juridik, me faktin se kishte ndodhur transaksioni në mes tyre si shitës dhe blerës. Këtë raport juridik paditësi e materializon duke hy në posedim të pa penguar para 3 viteve më parë.

Gjykata për tërë këtë raport juridik mes palëve ndërgjyqëse u shërbye me të drejtën materiale e cila ishte në fuqi gjatë krijimit të këtyre raporteve, siq është neni 28, i LMD-së, sepse vullneti i palëve ka fuqi detyrimi dhe është mbi ligjin – autonomia e vullnetit, duke shtuar se ajo që kontraktuesit kanë percaktuar me kontratë – është ligj për ta. Gjithashtu edhe parimi “solo consensus” (pa pasur nevojë për përmbushjen e formës së caktuar), është përmbushur. Pastaj parimi i ndershmërisë dhe ndërgjegjshmërisë, objekti dhe baza e kontrates ishin të lejueshme nga palët.

Andaj, gjykata duke u bazuar në gjitha këto prova dhe fakte të pakontestueshme, duke qenë e pavarur në vendosje miratoi kërkesëpadinë e paditësit.

Shpenzimet e procedurës do t'i barti paditësi A.R.neni 453 dhe 454. i LPK-së.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË VITI

C.nr. 412/2013

Më. 28.12.2016

Gj y q t a r i,
Raif Fazliu

UDHËZIMI PËR MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njejtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.